



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, nenit 19 dhe 20 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve 15Nr.011-70915 e datës 28.12.2016, Vendimit të Kuvendit të Komunës për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermer 15Nr.400-33781 i datës 29.06.2017, Vendimit të Kryetarit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e fermerëve të Komunës së Lipjanit 1Nr.400-38442 i datës 19.07.2017, Rekomandimit të Komisionit - aktit mbi shpalljen e listës përfundimtare të përfituesve të serrave pas shqyrtimit të ankesave Nr.12-320-38359 të datës 04.12.2017 si dhe Rekomandimit të Komisionit për zëvendësimin e përfituesve nga subvencionet komunale me sera nr.12-320-38359 i datës 20.12.2017, Kryetari i Komunes nxjerr:

**VENDIM**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR NDARJEN E SERRAVE 1Nr.320-64862 TË DATËS 06.12.2017**

I. Me këtë Vendim ndryshohet dhe plotësohet neni 1 i Vendimit për ndarjen e serave 1Nr.320-64862 të datës 06.12.2017, në pjesën tabelare të përfituesit e serave ashtu që:

- a. Përfituesi Agron Sylejmani nga Konjuhi në numrin rendor 54 zëvendësohet nga përfituesi nga lista rezervë Sami Mehmeti nga Konjuhi.
- b. Përfituesi Bunjamin Jashanica nga Lipjani në numrin rendor 128 zëvendësohet nga përfituesi nga lista rezervë Hazbi Bytyqi nga Sllovia.

II. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

**Arsyetim**

Ndryshimi dhe plotësimi i Vendimit të cekur bëhet konform Rekomandimit të Komisionit për zëvendësimin e përfituesve nga subvencionet komunale me sera nr.12-320-38359 i datës 20.12.2017 përshkak se përfituesit e cekur kanë bërë kërkesë për tërheqje për shkak të hapësirës së limituar .

Vendimi dërgohet:

Drejtoratit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural  
Kryesuesit të Komisionit- Pajtim Krasniqi

1Nr. 320-38359  
Lipjan, më 20.12.2017

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

